



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË
DREJTAT E NJERIUT

Tiranë, më 20.02.2024

Dokument parlamentar
Komision Përgjegjës

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR DHËNIE AMNISTIE”

• **HYRJE**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjet *online* të datës 07.02.2024 dhe 20.02.2024 në cilësinë e komisionit përgjegjës, mori në shqyrtim projektligjin “*Për Dhënie Amnistie*”.

Për të prezantuar dhe dhënë shpjegime për projektligjin në komision ishin të pranishëm Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja dhe stafi mbështetës nga kjo ministri.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin z. Plarent Ndreca.

• **BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji është iniciativë e Këshillit të Ministrave sipas përcaktimeve të nenit 81 pika 1 dhe 2 e Kushtetutës shkronja “ë” dhe paraqitet për shqyrtim dhe miratim bazuar në nenet 78 dhe 83, pika 1 dhe 2 të Kushtetutës.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji, rezulton se miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të miratimit me shumicë të cilësuar (prej 3/5 të të gjithë anëtarëve të Kuvendit).

Gjithashtu, si bazë ligjore e këtij akti është dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në bazë të së cilit në nenin 71 parashikohet se: “*Me aktin e amnistisë, organi kompetent përjashton nga ndjekja*

penale, nga vuajtja, tërësisht apo pjesërisht, e dënimit ose bën zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë. Amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj, veç rastit kur në aktin përkatës vendoset ndryshe”.

Projektligji shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit.

• QËLLIMI DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji për dhënie amnistie është trajtimi njerëzor dhe respektimi i dinjitetit të individit, riintegrimi dhe rehabilitimi social i personave të dënuar dhe të atyre që janë duke u ndjekur penalisht për vepra penale të lehta.

Parimet e amnistisë reflektojnë parimet që sanksionohen në Kodin Penal ku ndër të tjera vlerësohet parimi i humanizmit.

Qëllimi i nismës konsiston në amnistinë e dënimit, e cila ndërhyt pas dhënies së një vendimi përfundimtar dënimi, duke shuar tërësisht ose pjesërisht ekzekutimin e tij, si dhe amnistinë e ndjekjes penale, procedimit penal dhe gjykimit penal vetëm për ato vepra dhe në ato raste kur ligji nuk e ndalon.

Duke parë në mënyrë të ndërthurur të gjitha institutet e ligjit penal për veprat e lehta penale, për të miturit dhe për autoritetet femra, vlerësohet se dhënia e dënimit nga gjykata apo kryerja e dënimit e arrin qëllimin e vet edhe pa qenë nevoja për ekzekutimin e plotë të tij.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të aplikohet një politikë lehtësuese penale për t’u dhënë mundësi personave të dënuar të vijojnë me rehabilitimin dhe riintegrimin në shoqëri duke vlerësuar se qëllimi i dënimit penal është arritur.

Si rrjedhojë e kësaj nisme, krijohen lehtësi në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale duke ndihmuar në uljen e numrit të popullimit në këto institucione. Ndodhur në kushtet e mbipopullimit në burgje, aktualisht, kjo masë do të ndihmonte në uljen e numrit të personave të dënuar që qëndrojnë në këto ambiente dhe do t’i jepte mundësi institucionit të përdorë të gjitha kapacitetet për të dënuarit e tjerë për vepra penale më të rënda.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, në Republikën e Shqipërisë, janë aplikuar amnisti përkatësisht në vitin 2014, 2016 dhe 2020 duke zbatuar kësaj politikë penale lehtësuese për vepra penale të lehta, në kuadër të rehabilitimit social të personave që kanë kryer vepra penale, si dhe në kuadër të optimizimit të kapaciteteve në burgje.

Aplikimi i amnistisë vlerësohet edhe në raport me sistemin e dënimeve, në thelb të të cilit funksionon parimi se sanksionet penale duhet të udhëhiqen nga parimet kushtetuese dhe funksionet që i karakterizojnë ato, përkatësisht ai edukativ (funksioni i parandalimit të përgjithshëm të veprave penale) dhe ai i parandalimit të posaçëm (që lidhet me riedukimin e autorit të veprës penale).

Rishtë:

Projektakti i propozuar për dhënie amnistie përfshin dhe ofron rishtë e mëposhtme:

- ❖ Rehabilitim dhe riintegrim në shoqëri të personave që kanë kryer vepra penale;
 - ❖ Lehtësitë në sistemin penitenciar: Nëpërmjet zbatimit të amnistisë, një nga efektet kryesore është edhe ulja e numrit të të dënuarve në institucionet penitenciare. Ulja e numrit të personave të burgosur përmirëson kushtet në institucione, duke garantuar trajtimin e tyre në përputhje me rregullat evropiane të burgjeve.
 - ❖ Lehtësimi i vëllimit të punës në organet e prokurorisë dhe gjykatave.
- **VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BASHKIMIT EVROPIAN**

Ky projektakt nuk synon përafrimin me acquis të BE-së.

- **KONSULTIMI PUBLIK**

Ky projektligj nuk është hedhur në platformën e Kuvendit për konsultimin publik.

Nga relacioni i Këshillit të Ministrave rezulton se projektligji është bashkërenduar me mendimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe marrjen e mendimit Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

- **EFEKTET FINANCIARE**

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell detyrime financiare për Republikën e Shqipërisë.

- **PËRMBAJTJA E PROJEKTAKTIT**

Aktualisht sistemi penitenciar ka 5761 të burgosur dhe paraburgosur, nga të cilët 2116 janë të burgosur.

Nga kjo amnisti pritet të përfitojnë rreth 600 prej tyre.

Gjatë hartimit të projektligjit është pasur në vëmendje që kategoritë e veprave penale që parashikojnë rrezikshmëri të lartë shoqërore ose të dënuarit që paraqesin rrezikshmëri të theksuar, të përjashtohen nga kjo amnisti, si konkretisht: veprat penale kundër jetës e personit, si vrasja, plagosja, dhuna në familje, veprat penale kundër mjedisit, terrorizmit, korrupsioni etj.

Në kuptim të sa më sipër, sipas propozimeve në projektligj:

Amnistohen:

- Të dënuar burra me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 3 vjet dhe persona të dënuar me mbi 3 vjet, por që u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim një periudhë deri në 3 vjet.
- Të dënuara gra me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 4 vjet dhe gra, që janë dënuar me vendim të formës së prerë mbi 4 vjet, që u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim një periudhë deri në 4 vjet.
- Personat e dënuar gra, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 50 vjeç.
- Personat e dënuar burra, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 60 vjeç.
- Personat e dënuar me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baras ose nën moshën 18 vjeç.

Të gjithë të dënuarit përfitojnë nga kjo amnisti, duke parashikuar zbritje të dënimit, përkatësisht për gratë dhe të miturit 1 vit e gjysmë dhe për burrat 1 vit duke përjashtuar disa persona që kanë kryer vepra penale kundër jetës, ata që janë dënuar me burgim të përjetshëm apo subjektet që janë dënuar nga Gjykata e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.

Lidhur me rastet e ndjekjes penale për vepra penale të lehta të parashikuara me dënim maksimumi deri në 2 vjet, të cilat përfshihen në këtë amnisti, shuhet ndjekja penale, procedimi penal apo kallëzimet e rregjistruara deri në 30.11.2023, përveç 24 veprave përjashtuese që i parashikon dispozita përkatëse.

Afati i shtrirjes së amnistisë për shuarjen e dënimit dhe shuarjen e ndjekjes penale është data 30.11.2023.

Nuk amnistohen:

Nëse një person i dënuar përfiton nga kriteret e përmendura më lart, nuk përfiton nga amnistia, nëse veprat penale që ka kryer janë parashikuar si kritere ndaluese në këtë projektligj.

Projektligji përjashton nga fusha e tij e zbatimit kategoritë e veprave penale që parashikojnë rrezikshmëri të lartë shoqërore ose të dënuarit që paraqesin rrezikshmëri të theksuar, të cilat në grupime të përgjithshme veprash penale, janë veprat penale të listuara në ligj lidhur me:

- krimet kundër njerëzimit;
- krimet e rënda kundër jetës;
- veprat penale të kryera me dashje kundër shëndetit;
- krimet seksuale;
- veprat penale kundër lirisë së personit;

- veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit;
- veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes;
- vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike;
- vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve;
- veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve;
- vepra penale kundër mjedisit;
- krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues;
- krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera;
- vepra me qëllime terroriste;
- krime kundër autoritetit të shtetit;
- vepra penale kundër drejtësisë;
- vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;
- vepra penale të kryera nga banda të armatosura dhe organizata kriminale.

Njëkohësisht, nuk përfitojnë nga amnistia personat e dënuar me burgim për veprat penale të parashikuara:

- në nenet 79, 79/a, 79/b, 79/c, të Kodit Penal,
- personat e dënuar me burgim të përjetshëm,
- personat e dënuar, akuzat penale ndaj të cilëve janë gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu, përjashtohen nga amnistia personat që i janë shmangur drejtësisë. Ky parashikim është bërë për shkak se qëllimi i amnistisë është rehabilitimi i personave dhe personat që i shmangen drejtësisë nuk mund të përfitojnë nga kjo masë e cila në thelb ka humanizmin dhe riintegrimin, pasi me veprimet e tyre kanë treguar se nuk janë në kushtet e rehabilitimit dhe nuk synojnë pikërisht këtë riintegrim.

• DIKSUTIME NË KOMISION

- **Në mbledhjen e datës 07.02.2024**, Kryetarja e Komisionit, Znj. Bushka, ftoi Ministrin e Drejtësisë, Z. Ulsi Manja dhe përfaqësuesit e tjerë të ftuar për të prezantuar projektligjin. Ministri Manja gjatë prezantimit referoi se numri i përfituesve nga miratimi i projektligjit do të jetë rreth 600 të dënuar dhe 2500 në shërbim prove.

Z. Manja u ndal se janë aplikuar kritere ndaluese në dhënien e amnistisë për veprat penale me rrezikshmëri të lartë si: vrasja, dhuna në familje, shpërdorimi i detyrës dhe korrupsionit, veprat që hetohen/gjykohen nga *Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK)/ Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (GJKKO)*, subjektet e deklarimit të pasurisë, aplikimi i zbritjes së dënimit bëhet për të gjithë personat e dënuar me përjashtim të atyre personave

që janë subjekt i gjykimit nga GJKKO, ata që kanë kryer vepra penale kundër jetës në rrethana cilësuese si dhe ata të dënuar me burgim të përjetshëm.

Nisur dhe nga pyetjet e relatorit Z.Plarent Ndreca, Ministri u ndal në realitetin e strukturave penitenciare ku përmendi kryesisht: mbipopullimin e burgjeve dhe tejkalimin e kapaciteteve krahasuar me standartet e diktuar nga BE, raportin e të dënuarve me ata të paraburgosur, ku rezultoi se nga të dhënat e përditësuara të dënuar janë 2204 ndërsa të paraburgosur 3158, informoi se ka të dënuar me masa mjekësore, të dënuar me burgim të përjetshëm, ndërsa 11290 persona janë në shërbim prove.

Ministri Manja vlerësoi gjatë referimit të tij se amnistia nuk duhet konsideruar si një ndërhyrje në punët e drejtësisë, por duhet konsideruar si masë e domosdoshme, pasi krijon mundësi të menaxhimit të sistemit.

Në vijim Z.Manja citoi në mënyrë të përmbledhur kriteret për kufizimet dhe kategoritë që nuk përfitojnë duke mbajtur në konsideratë parimet e së drejtës si dhe duke vlerësuar se një ndër qëllimet e amnistisë është mbrojtja e interesit publik. Ministri Manja sqaroi gjithashtu se për disa të dënuar edhe pse kanë kryer kundërvajtje penale, janë përjashtuar nga përfitimi i amnistisë sepse kanë kryer vepra që kanë të bëjnë me cënimin e nderit dhe dinjitetit të personit apo çënojnë jetën private. Në tërësi janë 24 vepra që janë përjashtuar nga pushimi i ndjekjes penale që kanë të bëjnë me fenomene të shpeshta dhe sensitive për opinionin publik.

Në vijim të diskutimeve, Kryetarja e Komisionit Znj. Bushka nënvizoi raportin e Komitetit të parandalimit të torturës të Këshillit të Evropës për t'u adresuar si çështje në një dëgjuesë të posaçme në Komision me qëllim ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve në atë raport nga Kuvendi, duke kërkuar që të përcillen, në vijim, të dhëna statistikore shtesë nga Ministria e Drejtësisë.

Në Komision u vijua diskutimi me nevojën që sistemi i drejtësisë të orientohet te dhënia e masave të sigurimit në mënyrën e duhur dhe ku për vepra penale me rrezikshmëri të ulët të aplikohen masa të tjera alternative dhe jo ajo e arrestit me burg, e cila duhet të konsiderohet si masa më e fundit.

U diskutua nga deputetët dhe u sugjerua që të ndryshohet data e hyrjes në fuqi të amnistisë duke qenë se u vonua në fund të vitit 2023, që nga koha kur u depozitua. Kjo qasje shkon edhe në të njëjtin kah dhe të njëjtën frymë zbatimi me vetë përcaktimin e Kodit Penal, në të cilin shprehimisht parashikohet se:

“Amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj, veç rastit kur në aktin përkatës vendoset ndryshe”.

Kjo çështje është diskutuar edhe në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, i cili e ngriti këtë shqetësim dhe qasje që të ndryshojë data e shtrirjes së efektit të amnistisë.

Mbledhja vijoi me diskutime nga deputetët lidhur me harmonizimin apo me kriteret e përjashtimit të veprave penale, por më së shumti të kundërvajtjeve penale, cilat prej tyre nuk janë të përfshira për

të përfituar nga amnistia e vuajtjes nga dënimi apo ato të përjashtuara në përfitimin e amnistisë për pushimin e ndjekjes penale si dhe në mundësinë e zgjerimit të subjekteve përfitues dhe për cilat vepra.

Në lidhje me amnistinë për kategorinë e grave e të të miturve, Kryetarja e Komisionit, Znj. Bushka propozoi nëse mund të ketë hapësira që nëpërmjet këtij akti të përfitohet edhe më shumë për të miturit dhe gratë.

➤ **Në mbledhjen e datës 20 shkurt 2024**, Komisioni u rimblodh për të shqyrtuar projektligjin, pas marrjes së konsultimit edhe nga Ministria e Drejtësisë lidhur me disa amendamente të paraqitura nga deputetët e opozitës si dhe rishikuar çështjet që kishin ngritur relatori Z. Ndreca dhe riformulimet e reja të draftit të paraqitura prej tij në cilësinë e relatorit të projektligjit.

Nismat e depozituara zyrtarisht me shkrim me amendamentet përkatëse të formuluar nga deputetët propozues z. Alibeaj, z. Nallbati, z. Salianji dhe z. Xhaferri dhe arsyetimi përkatës i tyre, janë administruar në komision dhe shqyrtuar me kujdes edhe nga Ministria e Drejtësisë. Z. Alibeaj në cilësinë e anëtarit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, e ka prezantuar në komision propozimin e tij.

Gjithashtu, u vlerësua në mbledhje se edhe në mbledhjet e komisionit të sigurisë për dhënie mendimi dhe në atë të ligjeve, deputetët kanë qenë shumë aktivë me diskutime e pyetje lidhur me parashikimet e draftit të Qeverisë, duke sugjeruar për nene të caktuara riformulime apo përmirësime të mëtejshme në dispozitat e projektligjit si dhe në kuadër të propozimeve të paraqitura nga deputetët e lartcitar, drafti i projektligjit ka pësuar ndryshime duke pranuar propozimet e paraqitura në frymën e parimeve të Amnistisë Penale, të Kodit Penal si dhe respektimit të vendimeve të gjykatave.

➤ **Në mënyrë të përmbledhur amendamentet e deputetëve konsistojnë në këto ndryshime:**

1. Amendamenti i z. Xhaferri:

Propozon që të pushohen të gjitha çështjet penale të pashqyrtuara ose në proces shqyrtimi nga gjykatat e apelit, për veprat penale të kryera deri në datë 30.06.2023 për të cilat gjykatat e shkallëve të para kanë dhënë dënim me burgim deri në 2 vjet, ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, me përjashtim të dënimeve për veprat penale të përcaktuara në pikën 1 të projektligjit të propozuar.

Gjithashtu pika 3 e nenit 5 të bëhet pika 4 dhe të riformulohet: “4. Nuk përfitojnë nga ky nen subjektet që mbartin detyrimin për të deklaruar sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” që po hetohen apo gjykohen për vepra penale të parashikuara nga neni 4 i këtij ligji si dhe subjektet e posaçme, akuzat penale ndaj të cilëve po gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar sipas përcaktimeve të shkronjës “c” dhe “ç”, të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale”.

2. Amendamenti i z.Salianji:

Propozon përjashtimin nga amnistia të gjithë atyre shtetasve që janë aktualisht deputetë të zgjedhur apo kanë qënë të zgjedhur në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, dhe konkretisht pika 3 e nenit 5, të riformulohet me përmbajtjen si vijon:

“3. Nuk përfitojnë nga ky nen subjektet që kanë detyrimin për të deklaruar sipas ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, subjektet e posaçme, akuzat penale ndaj të cilave gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar sipas përcaktimeve të shkronjave “c” dhe “ç”, të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale si dhe çdo deputet apo ish deputet i zgjedhur më parë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë”.

3. Amendamenti i Z. Alibeaj:

1. *Propozimi synon përfitimin e amnistisë nga vuajtja e dënimit (lirim nga burgu) për personat që kanë kryer vepra penale që parashikon Kodi Penal (6 nene: përkatësisht nenet: 150, 151, 235, 236, 237, 282 të Kodit Penal), të kryera gjatë tubimeve/protestave politike dhe qytetare të organizuara gjatë periudhës: 01.10.2018-31.12.2020.*

Këto nene kanë të bejnë me: shkeljen e rregullave për përdorimin e lëndëve plasëse/djegëse (282); kundërshtimi i punonjësit që kryen shërbim publik ose detyrë shtetërore (235); kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik (236); goditjet për shkak të detyrës (237); shkatërrimi i pronës (150); shkatërrimi i pronës me zjarr (151). Këto vepra janë kryer gjatë protestave të cituara nga deputeti propozues.

2. Propozimi kërkon që nëpërmjet heqjes së nenit 237 nga kriteret ndaluese, të përfitojnë nga vuajtja e mëtejshme e dënimit edhe personat e dënuar për veprën penale 237 “goditje për shkak të detyrës”.

3. Propozimi kërkon edhe amnistinë e ndjekjes penale për të gjithë protestuesit që kanë kryer veprat penale të mësipërme dhe për periudhën e specifikuar, për të cilat kërkon edhe të lirohen menjëherë nga burgu ata që janë të dënuar.

4. Amendamenti i z.Nallbati:

Propozimi konsiston në tre amendime të projektligjit:

1. *Barazi para ligjit edhe në aspektin gjinor.* Pra, lirimin nga vuajtja e mëtejshme e dënimit të të gjithë burrave që janë dënuar deri në 4 vite burg apo që u ka mbetur nga dënimi për të vuajtur deri në maksimumi 4 vite. Pra, kërkohet unifikim/barazim i përfitimit të viteve të dënimit të burrave me 4 vite njësoj si për burrat ashtu edhe për gratë që e kanë parashikimin 4 vjet, ndërsa për të dënuarit burra përcaktimi aktual është 3 vjet në draftin e projektligjit.

2. *Amendimi i dytë:* Heqjen nga kriteri ndalues të parashikuar tek neni 4 i projektligjit, të paragrafit të dytë dhe të katërt të nenit 245/1, të Kodit Penal “ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave

që ushtrojnë funksione publike”. Kjo veprë penale hetohet dhe gjykohet respektivisht nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe gjykuar nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si një ndër veprat e posaçme penale të specifikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

3. *Amendim i tretë*: Pushimin e ndjekjes penale për veprën penale 245/1 “ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” paragrafi i parë dhe i tretë, me një marzh dënimi deri në 2 vjet burg.

Këto amendamente, të cituara më sipër, janë analizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe duke u bashkërenduar edhe me relatorin, u diskutuan gjatë mbledhjes.

➤ **Marrja në konsideratë e amendamenteve të deputetëve :**

Nga shqyrtimi i amendamenteve merren në konsideratë një pjesë e propozimeve që kërkohen nga Z. Alibeaj, ndërsa një pjesë është e përfshirë në projekt ligjin e propozuar nga Qeveria. Konkretisht nenet 150 “Shkatërrimi i pronës”, 235 “Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik dhe 236 “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, të kërkuara nga z. Alibeaj, janë përfituese të amnistisë, ato nuk janë të përfshira tek kriteret ndalues të amnistisë nga vuajtja e dënimit në nenin 4, sipas variantit të projektligjit të Qeverisë. Po ashtu, edhe neni 282 që parashikon si veprë penale “Shkeljen e rregullave mbi lëndët plasëse dhe djegëse”, duke qenë se paragrafi i parë i tij nuk është kriter ndalues në nenin 4, është i përfshirë në përfitim nga amnistia, në varësi të masës së dënimit dhe plotësisht të kushteve të nenit 3 .

Në tërësi, edhe pas ndryshimeve të relatuara nga relatori, të gjitha veprat penale që propozohen nga deputeti Alibeaj përfitojnë amnisti nga vuajtja e dënimit, përveç veprës penale që parashikohet në nenin 237 të Kodit penal “Goditjet ose vepra të tjera dhune ndaj punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore apo të shërbimit publik” dhe nenit 151 të Kodit penal “Shkatërrimi i pronës me zjarr”. Po ashtu, të gjitha këto vepra penale përfitojnë zbritje dënimi sipas parashikimit të nenit 5 të projektligjit, me 1 vit burrat dhe 1.5 vite gratë dhe të miturit.

Lidhur me propozimet për amnistinë e ndjekjes penale, që parashikohet sipas kriterëve të nenit 6, është marrë në konsideratë pjesërisht propozimi për tu përfshirë në nenin 6 të projektligjit (*pushimi i ndjekjes penale, të çështjeve penale në hetim, çështjeve të pashqyrtuara ose në proces shqyrtimi nga gjykatat, si dhe kallëzimet që ndodhen në këto organe, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, për veprat penale të kryera deri në datën e propozuar 31.02.2024, për të cilat Kodi Penal dhe Kodit Penal Ushtarak parashikon një dënim me burgim në maksimum deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë*), duke hequr paragrafin e parë të nenit 236 (kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit), si dhe hequr paragrafi i parë i nenit 238 (kanosja për shkak të detyrës) nga kriteret ndaluese të përfitimit nga pushimi i ndjekjes penale. Në analizën e propozimeve

për setin e veprave penale që propozohen nga deputeti Alibeaj, për tu përjashtuar edhe nga ndjekja penale, mbahet në konsideratë fakti se përjashtimi nga ndjekja penale realizohet për ato vepra penale, të cilat dënohet deri në maksimum deri në 2 vjet, duke respektuar në këtë mënyrë të njëjtën linjë të parashikuar në parimet e kësaj amnistie.

Kërkesa për të përfshirë vepra penale në pushim nga ndjekja penale, të cilat dënohet në maksimum mbi 2 vjet, sjell deformim të të gjithë standartit të parashikuar në këtë amnisti dhe krijon pabarazi në trajtim, për shumë vepra të tjera penale që nuk përfshihen në amnisti, pikërisht sepse tejkalojnë këtë “tavan” të dënimit sipas Kodit Penal.

Tek amendamentet e propozuara nga Z.Nallbati, janë pranuar shumica dërrmuese e tyre, duke reflektuar propozimet për rritjen e viteve të përfitimit nga vuajtja e dënimit tek burrat nga dënimet deri në 3 vjet në dënimet deri në 4 vjet, standard i ndjekur ky njësoj edhe tek rritja me një vit e përfitimit lidhur me vitet e mbetura të dënimit me burg, po ashtu edhe përsa i takon veprës penale 245/1 (*paragrafi i 2-të dhe i 4 te kriteri ndalues për përfitimin nga vuajtja e dënimit*) që hiqet nga neni 4, kriteri ndalues, si dhe propozimi për heqjen po të këtij neni (*paragrafi i 1-rë dhe i 3-të*) si kriter ndalues tek neni 6 i projektligjit e që ka të bëjë me përfitimin nga pushimi i ndjekjes penale.

Përsa i takon amendamenteve të deputetëve Xhaferri dhe Salianji:

Amendamenti i deputetit Salianji: propozimi është i përfshirë në projektligj. Subjektet deputetë dhe ish deputetë janë të përfshirë tek kriteri ndalues edhe për shkak të statusit. Po ashtu, deputetët dhe ish deputetët po t’i referohemi kompetencave të SPAK dhe GJKKO sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, janë të përfshirë si subjekte të posaçme konkretisht te pika c) dhe ç) e nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon :

c) “*akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;*

ç “*akuzat penale kundër **ish-funksionarëve të mësipërm**, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës*”.

Sa më sipër ky propozim me shkrim nuk është i nevojshëm dhe nuk paraqet asnjë risi për ndryshim pasi gjëndet i përfshirë në projektin e amnistisë së propozuar nga Qeveria.

Amendamenti i deputetit Xhaferri: është e paqartë referenca dhe nuk ka kuptueshmëri të neneve që propozohen, pasi rezulton të jetë punuar jo me variantin e draftit të projektligjit dhe neneve përkatëse e termave të tij. Gjithsesi, nëse i referohemi çështjes së procesit të gjykimin në gjykatat e apelit, nuk ka asnjë dallim me çfarë është tashmë e parashikuar në projektligjin e amnistisë, pasi këto gjykime janë të përfshira te neni 6 i amnistisë për përfitimin e pushimit të hetimit/ndjekjes penale ku përcaktohet: “çështjet në proces shqyrtimi nga gjykatat”. Pra, çështje për të cilat nuk ka përfunduar gjykimi në dy shkallët e gjyqësorit dhe nuk është dhënë një vendim përfundimtar i formës së prerë.

Në fjalën e tij, relatori Z.Ndreca shprehu se ky projektligj është shumë i rëndësishëm, pasi jo vetëm lehtëson punën e organeve ekzekutuese penale, por njëkohësisht i jep një frymëmarrje lehtësuese edhe organeve të drejtësisë, atyre të hetimit penal dhe patjetër në frymën e humanizmit lehtëson edhe ata persona që janë të dënuar dhe janë nën hetim për vepra të lehta penale, duke iu mundësuar riintegrimin dhe rehabilitimin.

Në vijim, ai parashtrroi të gjitha ndryshimet e bëra pas konsultimit të amendamenteve të deputeteve dhe pas marrjes së opinionit të Ministrisë së Drejtësisë si propozues i nismës, dhe duke mbajtur në vëmendje të gjitha diskutimet dhe çështjet e trajtuara edhe në mbledhjen e parë, por edhe sugjerimet e deputeteve të tjerë dhe ato të zhvilluara në Komisionin e Sigurisë. Në koordinim edhe me Ministrin e Drejtësisë, janë përfshirë pjesa dërrmuese e propozimeve që ka paraqitur z. Alibeaj dhe z.Nallbati.

• **Ndryshime të variantit të projektligjit pas ripunimit nga Relatori duke mbajtur në konsideratë edhe propozime të deputetëve:**

- ✓ Kudo në projektligj sugjerohet që data e shtrirjes së efektit të amnistisë të jetë për të gjitha ato dënime të dhëna me vendim të formës së prerë dhe ato që janë në ndjekje penale deri më datën 31.01.2024.
- ✓ Nisur edhe nga parimi i humanizmit, sugjerohet **reformulimi i nenit 3** të projektligjit, ku amnistia të shtrihet për dënimin penal për të gjitha veprat penale që dënohen deri në 4 vjet për burrat dhe deri në 5 vjet për gratë si dhe te pjesa e mbetur e dënimit, shtohet me nga një vit, gjithashtu përfitojnë për pjesën e mbetur të dënimit 4 vite burrat dhe 5 vite gratë. Pra bëhet një shtesë e përfitimit nga vuajtja e dënimit me nga një vit njësoj për burrat e dënuar dhe gratë e dënuara për parashikimet e gërmave *a, b, c, dhe ç*.
- ✓ Në **nenin 4, ndryshon gërma “k”** duke hequr veprat penale 238 “*kanosja për shkak të detyrës*” dhe 245/1 paragrafi 2 dhe 4 “*ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” si propozime edhe të z. Nallbati dhe është shtuar si kriter ndalues paragrafi i parë i nenit 263 të Kodit Penal. Njëkohësisht nga komisioni u vendos të shtohet edhe neni 257 i Kodit Penal në kriteret ndaluese, pasi edhe kjo vepër penale është ndër ato vepra që hetohet/gjykohet nga SPAK/GJKKO. Në variantin e ardhur nga Qeveria kjo vepër nuk ishte përfshirë në kriteret ndaluese.

Specifikisht shkronja “k”, e pikës 1, të nenit 4 ndryshohet si më poshtë:

“k) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 237, 243, 244, 244/a, 245, në paragrafin e dytë të nenit 247, në nenet 248, 248/a, 250, 252, 253, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, paragrafin e parë të nenit 263, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 267, 268, 270, 271, në paragrafët e parë, të dytë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë të nenit 278, në nenet 278/a, 278/b, në paragrafin e dytë të nenit 281, në paragrafin e dytë të nenit 282, në nenet 282/a, 282/b, 282/c, 283, 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 284/d, 285, 286, 287, 287/a, 287/b, 288, 288/a, 288/b, 288/c,

288/ç, në paragrafin e dytë të nenit 289, në paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt të nenit 290, në paragrafin e dytë të nenit 292, në nenet 293/a, 293/b, 293/c, 293/ç, 294, 295, në paragrafët e parë, të tretë, të katërt, të pestë dhe të gjashtë të nenit 295/a, në paragrafin e katërt dhe të pestë të nenit 298, në nenin 299 të Kodit Penal, si dhe në nenin 70 të Kodit Penal Ushtarak;”.

✓ **Sugjerohet ndryshimi i nenit 5:** Në pikën 2 shkronja “c” **shfuqizohet**.

Pra, hiqet shkronja c) që parashikon:

ç) personat e dënuar, akuzat penale ndaj të cilëve janë gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

Kjo ndërhyrje bëhet në kuadër të repektimit të parimit kushtetues të “barazisë para ligjit” parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës. Qëllimi është që ndërmjet personave të dënuar me vendim të formës së prerë, të mos ketë diferencim në përfitimin e 1 vit ulje dënimi për burrat dhe 1.5 vite ulje për gratë, pavarësisht nga gjykata që e ka marrë vendimin. Në kushtet kur, sipas variantit të Qeverisë, përfitonin vepra shumë më të rënda se shumë prej atyre që gjykohen nga GJKKO, nuk mund të mospërrjashtoheshin nga përfitimi i zbritjes së dënimit kjo kategori vetëm për shkak se janë gjykuar nga një gjykatë e posaçme. Nëse përfiton ulje dënimi një i dënuar nga një gjykatë e juridiksionit të përgjithshëm për “vrasje”, që e ka marzhin e dënimit 10-20 vite burg, sigurisht që në kuadër të parimit të “barazisë para ligjit” duhet të përfitojë nga ulja 1 vit burg (burra) apo 1.5 vite burg (gra), edhe persona të dënuar nga Gjykata e Posaçme, për të njëjtat vepra penale apo shumë më të lehta se “vrasja”. Në këtë argument merret në konsideratë edhe fakti që kategoria e nenit 5 është e përjashtuar nga përfitimi i nenit 3 të këtij projektligji, pra nga vuajtja e mëtejshme e dënimit.

Gjithsesi, në këtë nen vijojnë të mbeten të përjashtuar nga përfitimi i uljes së dënimit të dënuarit me burgim të përjetshëm dhe të dënuarit për krime kundër jetës ndaj personave në rrethana cilësuese (funksionarit publik, policit, marrëdhënie familjare etj).

✓ **Në nenin 6 “Kriteret për përfitimin e amnistisë nga ndjekja penale”**

Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

- data e përjashtimit të subjekteve që janë ende në hetim/ndjekje penale, proces shqyrtimi apo të patrajuara deri në 31.01.2024 (nga 31.11.2023 që ishte), për të cilat Kodi Penal dhe ushtarak parashikon deri në 2 vjet apo dënim më të butë, me përjashtim të disa ndalimeve që citohen te pika 1;

- tek veprat që nuk përjashtohen nga pushimi i ndjekjes penale të pikës 1 më lart, Komisioni ndryshon këto vepra:

✓ hiqen veprat penale 90 (rrahja), 92 (plagosje e lehtë nga pakujdesia), bëhet saktësim për nenin 112 (paragrafi i parë), hiqet paragrafi i parë i nenit 236 (kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit, hiqet paragrafi i parë i nenit 238 (kanosja për shkak të detyrës) si dhe hiqet

paragrafi i parë dhe i tretë i nenit 245/1 (ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj funksionarve publikë).

Këto ndryshime janë reflektim mbi propozimet e deputetëve të opozitës z.Alibeaj dhe z.Nallbati.

✓ **Pra, pika 1 e Nenit 6 riformulohet:**

“1. Përrjashtohen nga ndjekja penale të gjitha çështjet penale në hetim, çështjet e pashqyrtuara ose në proces shqyrtimi nga gjykatat, si dhe kallëzimet që ndodhen në këto organe, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, për veprat penale të kryera deri në datën 31.01.2024, për të cilat Kodi Penal dhe Kodi Penal Ushtarak parashikon një dënim me burgim në maksimum deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, me përjashtim të veprave të parashikuara nga nenet 91, 96, në paragrafin e dytë të nenit 112, në nenet 119, 119/a, 119/b, 120, 121, 122, në paragrafin e parë të nenit 124/b, në nenet 125, 127, 204, 205, 206, 207, në paragrafin e parë të nenit 257/a, në nenet 269 dhe 318 të Kodit Penal”.

✓ **Gjithashtu bëhet ndryshim edhe tek Pika 3 e nenit 6 e cila ndryshohet si më poshtë:**

“3. Nuk përfitojnë nga pika 1 e këtij neni subjektet, akuzat penale ndaj të cilave, gjykohen sipas përcaktimeve të shkronjave “c” dhe “ç”, të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.”

Ndryshimi konsiston në heqjen e paragrafit të parë të kësaj pike që parashikonte se nuk përfitojnë nga përjashtimi i ndjekjes penale as subjektet që mbartin detyrimin për të deklaruar sipas ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”.

Pra, hiqet përjashtimi nga përfitimi i amnistisë i zyrtarëve (që nuk janë zyrtarë të lartë, subjekt i SPAK), për veprat penale që dënohen deri në 2 vite burg. Me këtë ndryshim, një zyrtar i mesëm (jo subjekt i posaçëm i SPAK) nuk ka arsye pse të përjashtohet nga përfitimi i amnistisë nga ndjekja penale, për çdo lloj vepre penale që dënohet në maksimum deri në 2 vite burg, vetëm pse është subjekt i deklarimit të pasurisë. Një zyrtar i kategorisë së mesme, një drejtor drejtorie nuk ka arsye të përjashtohet nga përfitimi i amnistisë nga vepra penale p.sh. e “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” dhe që dënohet deri në 2 vite burg, vetëm pse është subjekt i deklarimit të pasurisë. Sigurisht një zyrtar i mesëm mund të përjashtohet nga përfitimi i amnistisë për vepra penale që kanë lidhje me deklarimin e pasurisë së zyrtarit, por jo për çdo lloj vepre që nuk ka lidhje me detyrën dhe që dënohet në maksimum deri në dy vite burg.

Për këtë arsye është shtuar si kriter ndalues për të përfituar nga ndjekja penale, vepra penale e parashikuar nga neni 257/a dhe që lidhet me refuzimin, mosdeklarimin apo fshehjen e pasurisë.

Njëkohësisht në këtë nen janë të përjashtuar nga përfitimi i amnistisë të gjithë veprat penale që hetohen nga SPAK dhe gjykohen nga GJKKO, për shkak të tavanit prej 2 vitesh të vendosur si kriter përfitues. Asnjë vepër penale që hetohet apo gjykohet nga SPAK/GJKKO nuk e ka maksimumin e dënimit të barabartë apo më të lartë se dy vite burg. Të gjithë ato vepra dënohen mbi dy vite burg në maksimum, për rrrjedhojë këto vepra nuk amnistohen nga ndjekja penale.

Gjithashtu janë të përjashtuar nga përfitimi i amnistisë të gjithë subjektet e posaçme që hetohen/gjykojnë nga SPAK/GJKKO sipas përcaktimeve të shkronjave “c” dhe “ç”, të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

- ❖ Në vijim të diskutimeve të mbledhjes dhe shqyrtimit të ndryshimeve të projektligjit, në fjalën e tij lidhur me amendamentin e propozuar prej tij, Z. Alibeaj sqaroi se:
“fakti që Partia Demokratike ka propozuar amendamente nënkupton se jemi në parim dakort me amnistinë, ndërkohë propozimet u referohen neneve 150, 151, 235, 236, 237 dhe 282 të Kodit Penal, lidhur me procedimet penale që kanë pësuar subjektet, të cilët janë thirrur në protesta nga ana e Partisë Demokratike apo nga shoqëria civile në periudhën kohore 2018-2019-2020 dhe se nuk nuk duhet ndjekur standard i ndryshëm nëse për të gjitha këto vepra penale të neneve 150, 151, 235, 236, 237, 282 kush është dënuar për to përfiton, del nga burgu, dhe kush është në procedim penal nuk duhet të procedohet”.
- ❖ Në fjalën e tij lidhur me dy propozimet e paraqitura nga deputetët Alibeaj dhe Nallbati Ministri Manja sqaroi se:
“pavarësisht përgjegjësisë politike që mban opozita që i ka thirrur qytetarët në protesta apo tubime politike, dhe se amnistia është një akt mëshire, duhet të kemi në vëmendje edhe përgjegjësinë penale kundrejt këtyre veprimeve, me qëllim mos përçimin e mesazhit të gabuar, se kur bëhet fjalë për protesta, nuk mund të ndërmarrin veprime të atilla që çojnë në cënimin e jetës së punonjësit të policisë, si rasti i punonjëses e cila humbi tre gishta, apo punonjësit që pësoi dëmtimë në sy, etj ; veprime që kanë shkaktuar plagosje të rëndë më dashje. Detyra jonë, dhe e çdo deputeti është edhe të mbajmë në vëmendje, që nëpërmjet nismave të tilla të mbrojmë interesin publik, por edhe jetën e punonjësve që janë aty për të garantuar sigurinë dhe mbarëvajtjen që protesta të tilla të mund të garantohen në përputhje me ligjet në fuqi”.

Në vijim, Ministri bëri një përmbledhje dhe shpjegim të të gjithë neneve që propozohen nga Z. Alibeaj dhe përfitimi përkatës në këtë amnisti nga ku për të gjitha nenet e propozuara ka përfitim në vuajtjen e dënimit në varësi të masës së dënimit dhe kushteve të nenit 3, përveç veprave penale që parashikon Kodi Penal në nenin 237 “Goditjet ose vepra të tjera dhune ndaj punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore apo të shërbimit publik” dhe nenin 151 “shkatërrimi i pronës me zjarr”, ndërsa zbritje të dënimit përfitojnë të gjitha veprat penale e propozuara.

Referuar propozimit të Z. Alibeaj për shtesë në nenin 3, pika 1, shkronja “ë”, dhe në nenin 6, si pikë më vete (neni 6/1) për përfitim nga amnistia të veprave 150, 151, 235, 236, 237 dhe 282, të Kodit Penal, janë pranuar vetëm disa nga propozimet si më poshtë:

- ❖ Për veprat penale të parashikuara në nenet 150, 235, 236, 238 të Kodit Penal, përfitohet amnisti në vuajtjen e dënimit, në varësi të masës së dënimit dhe në përmbushje të kushteve të nenit 3;
- ❖ Për veprën penale të parashikuar në nenin 237, përfitohet amnisti në vuajtjen e dënimit vetëm për gratë nëse përmbushin kriteret e nenit 3;

- ❖ Për veprën penale të parashikuar në nenin 282 të Kodit Penal, përfitohet amnisti në vuajtjen e dënimit vetëm për paragrafin e parë të këtij neni.
- ❖ Duke pasur në konsideratë qëllimin për të cilën kërkohet ky amendim, e cila ka të bëjë me tubimet dhe marrja pjesë në protesta, janë parashikuar si përfitues të saj, edhe veprat që lidhen me to, të parashikuar nga 261, 262 dhe 263 i Kodit Penal. Saktësisht përfitojnë amnisti:
 - a) Për të dënuar: veprat e parashikuara nga neni 261, 262 dhe paragrafi i dytë i nenit 263.
 - b) Ulje denimi: veprat e parashikuara nga neni 261,262,263.
- Ndërkohë lidhur me kërkesën për amnisti të këtyre veprave penale edhe për ndjekjen penale/hetimin aktual lidhur me to, kryesisht ndjekja penale në këtë amnisti është në suazën e kundërvajtjeve penale të cilat kanë një dënim në maksimumin e masës së parashikuar për veprën, deri në 2 vjet. Kjo është filozofia e kësaj amnistie dhe nëse rritet masa e dënimit për amnistinë do të duhet të bëhet për të gjitha veprat të së njëjtës natyre, për të siguruar barazinë përpara ligjit.
Gjithsesi, në propozimet e paraqitura janë pranuar dhe janë kategori përfituese edhe për ndjekjen penale :
 - Veprat e parashikuara në nenet 235,236,238: përfitohet në përjashtimin nga ndjekja penale, sipas paragrafit të parë të këtyre dy neneve;
 - Veprat e parashikuara në nenet 261, 262, 263; përkatësisht përfiton përjashtim nga ndjekja penale paragrafi i parë i nenit 261, i gjithë neni 262 si dhe paragrafi i dytë i nenit 263;
 - Veprat si, 238, 237, 282 etj, të cilat nuk kanë lidhje me protestat. Parashikimet e këtyre veprave dalin jashtë logjikës së formave të protestave apo tubimeve.
- Në lidhje me afatin e vendosur në amendament 01.10.2018 – 31.12.2020, në vlerësim të mos diskriminimit midis individëve të dënuar për të njëjtat vepra, si dhe në zbatim të nenit 18 të Kushtetutës, është vlerësuar e panevojshme vendosja e një fashe kohore, duke qënë që kjo amnisti tashmë do ta shtrijë efektin deri më 31.01.2024, sikurse u amendua në komision, që do të thotë që përfshihet edhe fasha kohore e kërkuar nëpërmjet këtij amendamenti.
- Po ashtu, është pranuar edhe një amendament tjetër që ka propozuar deputeti Bledion Nallbati, i cili me propozimin e tij, hapi një debat, për të siguruar atë që neni 18 i Kushtetutës në fakt e ka garantuar. Duke qënë se ulja e dënimit është për të gjithë, edhe për atë që ka kryer vrasje, bën sens të jetë edhe për atë që është dënuar nga Gjykata e Posaçme, duke qënë së ulja e dënimit përfshin të gjithë kategoritë e veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal, përveç vrasjeve në rrethana cilësuese dhe ato të dënuar me burgim të përjetshëm.

Në përfundim të fjalës së tij, Ministri Manja theksoi se nëse ky draft i amnistisë do të marrë votën në parlament, në këtë variant që propozohet edhe me amendamentet e pranuar dhe të dakordësuara me relatorin, përfitojnë 700 persona të dënuar dhe 2500 persona në shërbim prove. Për shkak të zgjerimit të gamës së kategorisë përfituese për zbritjen me 1 vit dhe me 1 vit e gjysmë për gratë e të

miturit, kategoria e përfituesve të cilët përfitojnë nga zbritja e dënimit shkon nga 1200 në 1600 persona të dënuar.

Në përmbyllje të diskutimeve të mbledhjes, Kryetarja e Komisionit Znj. Bushka theksoi se pavarësisht se amnistia është një instrument ligjor dhe politik i Kuvendit që u jep mundësinë e përfitimit atyre qytetarëve që janë dënuar apo ndodhen në procese gjykimi nga organet e drejtësisë, në varësi të kushteve dhe kriterëve që aplikohen në një akt të tillë, por kjo nuk do të thotë që nëse veprat penale përsëriten në të ardhmen, ata do të përfitojnë; ata përsëri do të dënohen. Qytetarët duhet të edukohen me faktin që amnistia nuk është akt “faljeje” i përhershëm, por është një akt humanizmi, i cili, në bazë të disa parimeve, tenton të arrijë disa përfitime për qytetarët dhe sistemin e drejtësisë.

Drafti i projektligjit është shqyrtuar me kujdes nga Ministri i Drejtësisë, relatori dhe të gjitha institucionet e drejtësisë, me të cilat është konsultuar jo vetëm projektligji, por edhe amendamentet e kolegëve deputetë, gjithashtu edhe institucionet e zbatimit të vendimeve, kanë dhënë detajet përkatëse sa u takon statistikave, për të kuptuar drejt se cilat janë efektet pozitive që vijnë nga kjo amnisti dhe ndryshimeve që pësoi ajo gjatë shqyrtimit të saj në komision.

• PËRFUNDIME

Komisioni në përfundim të të gjithë diskutimeve të deputetëve dhe të Ministrisë të Drejtësisë Z. Ulsi Manja, i pranishëm në këtë mbledhje, pas propozimeve të Relatorit të projektligjit Z. Plarent Ndreca të bashkërenduara me Ministrinë e Drejtësisë:

- *Duke marrë parasysh* disa nga amendamentet e deputetëve të opozitës së paraqitur me shkrim dhe të prezantuara në Komision, disa nga sugjerimet e Komisionit të Sigurisë, pas konsultimeve edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë për hapësirat për të marrë në konsideratë propozimet si dhe

- *Me qëllim* përmirësimit nga Komisioni i Ligjeve në cilësinë e komisionit përgjegjës të projektligjit dhe dispozitave që parashikon ai lidhur me amnistinë penale;

- *Duke mbajtur në konsideratë* parimet e Kodit Penal, që reflektohen edhe në parimet e amnistisë penale, parimin e barazisë para ligjit parashikuar në nenin 18, paragrafi i parë të Kushtetutës,

Diskutoi dhe miratoi projektligjin sipas tekstit integral, pjesë përbërëse e këtij raporti, me amendimet që konsistojnë në:

1. Efekti i amnistisë të jetë deri në datë 31.01.2024;
2. Rritet me nga një vit përfitimi nga vuajtja e dënimit për burra dhe gra;
3. Rritet me nga një vit përfitimi nga mbetja e viteve të dënimit për burra e gra;
4. Hiqen disa vepra penale nga kriteri ndalues i përfitimit të amnistisë si dhe bëhen disa saktësime në të;

5. Në kuadër të barazisë para ligjit sipas parashikimit të nenit 18, paragrafi 1 i Kushtetutës, dhe parimeve të Kodit Penal, përfshihen në përfitimin e zbritjes së dënimit me një vit burrat dhe 1.5 vite gratë, të subjekteve që nuk përfitojnë nga asnjë dispozitë tjetër e këtij projektligji, edhe subjektet, që janë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykatat e posaçme deri në 31.01.2024;
6. Në dispozitën për amnistinë e ndjekjes penale (neni 6), bëhet ndryshimi në pikën 3 për subjektet e deklarimit të pasurisë (jo zyrtarë të lartë që janë subjekt i hetimit nga SPAK) që të përfshihen edhe ata si përfitues sipas pikës 1 të nenit 6 (amnistia nga ndjekja penale për vepra penale për të cilat parashikohet dënim me burgim deri në dy vjet ose dënim tjetër më i butë), përveç kur këta zyrtarë (jo zyrtarë të lartë që janë subjekt i hetimit nga SPAK) hetohen për veprën penale parashikuar në nenin 257/a, që lidhet drejtëpërdrejtë me deklarimin e pasurisë.
Subjektet e deklarimit të pasurisë që janë subjekte të posaçme, akuzat penale ndaj të cilave gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar sipas përcaktimeve të shkronjave “c” dhe “ç” të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, nuk përfitojnë nga pika 1 e nenit 6, (amnistia e ndjekjes penale).
7. Hiqen disa vepra penale nga kriteri ndalues propozuar edhe nga deputetët, të lidhur me parashikimin e nenit 6 për përfitimin e amnistisë nga ndjekja penale, veprat penale të nenit 90 (rrahja), 92 (plagosje e lehtë nga pakujdesia), bëhet saktësim i nenit 112 (paragrafi i parë), hiqet paragrafi i parë i nenit 236 (kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit), hiqet paragrafi i parë i nenit 238 (kanosja për shkak të detyrës) si dhe hiqet paragrafi i parë dhe i tretë i nenit 245/1 “ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj funksionarve publikë”

Sa më sipër, Komisioni, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me 15 vota të anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë në parim, dhe vijoi sipas Rregullores së Kuvendit votimin nen për nen së bashku me të gjitha amendamentet e propozuara nga Relatori, që përfshin edhe amendamentet e deputetëve Alibeaj dhe Nallbati, të cilat u votuan me 15 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, si dhe në tërësi me po këtë shumicë votash, dhe ia kalon Seancës Plenare, së bashku me tekstin integral të ndryshuar, pjesë përbërëse e këtij raporti duke vlerësuar se:

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

RELATOR

KRYETARE

PLARENT NDRECA

KLOTILDA BUSHKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2024

PËR

DHËNIE AMNISTIE

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 e 2, shkronja “ë”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi dhe parimet e ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është të përjashtojë nga vuajtja e dënimit dhe ndjekja penale, tërësisht ose pjesërisht, të gjithë personat që plotësojnë kriteret, sipas dispozitave të këtij ligji.
2. Dhënia e amnistisë, sipas këtij ligji, udhëhiqet nga:
 - a) parimi i humanizmit;
 - b) arritja e qëllimit të dënimit;
 - c) rrezikshmëria e ulët e personave që amnistohen;
 - ç) edukimi dhe rehabilitimi;
 - d) mbrojtja e interesit publik;
 - dh) dhënia e mundësisë së integrimit më të lehtë dhe më të shpejtë të të dënuarve të mitur dhe femra;
 - e) rritja e efikasitetit në sistemin e drejtësisë;
 - ë) mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “I dënuar” konsiderohet:
 - a) personi i dënuar nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe që, brenda afatit ligjor, nuk është bërë ankim në gjykatat përkatëse të apelit, duke marrë formë të prerë brenda datës 31.01.2024;
 - b) personi i dënuar deri në datën 31.01.2024 nga gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykata e apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;
 - c) personi i dënuar deri në datën 31.01.2024 kur Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, si dhe personi i dënuar nga Gjykata e Lartë, kur kjo gjykatë ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë, deri në datën 31.01.2024.
2. “Person që i është shmangur drejtësisë” është personi i fshehur, i arratisur ose i ikur, i cili, megjithëse ka dijani, i shmanget me vullnet procedimit penal, zbatimit të masave të sigurimit ose ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të dënimit.

Neni 3

Kriteret për përfitimin e amnistisë nga vuajtja e dënimit

1. Përfshihen nga vuajtja e dënimit:
 - a) personat meshkuj, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 4 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31.01.2024, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi;
 - b) personat femra, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 5 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31.01.2024, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi;
 - c) personat meshkuj, dënuar me burgim, të cilëve deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 4 vjet;
 - ç) personat femra, dënuar me burgim, të cilave, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 5 vjet;
 - d) personat e dënuar meshkuj, të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë baras ose mbi moshën 60 vjeç;
 - dh) personat e dënuar femra, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 50 vjeç;
 - e) personat e dënuar me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baras ose nën moshën 18 vjeç.
2. Nuk përfshihen nga vuajtja e dënimit personat, të cilët i janë shmangur drejtësisë, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji.

Neni 4

Kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë

1. Pavarësisht nga parashikimet e shkronjave “a”, “c” dhe “d” të nenit 3 të këtij ligji, nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit personat e dënuar për:
 - a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a dhe 75 të Kodit Penal;
 - b) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 80, 81, 82, 83, 83/a, 83/b dhe 84/a të Kodit Penal, si dhe në nenin 77 të Kodit Penal Ushtarak;
 - c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, 88, 89/a, 93, 96 dhe 99 të Kodit Penal;
 - ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 107/a, 108 dhe 108/a të Kodit Penal;
 - d) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenet 109, 109/a, 109/b, 109/c, në paragrafin e dytë të nenit 110, në nenet 110/a, 110/b, 110/c dhe 111 të Kodit Penal;
 - dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në nenin 114, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 117, në nenet 119, 120, 121 dhe 121/a të Kodit Penal;
 - e) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 124, në nenin 124/a, në paragrafët e dytë e të tretë të nenit 124/b, në nenet 128/a, 128/b, 129 dhe 130/a të Kodit Penal;
 - ë) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në paragrafin e tretë të nenit 134, në nenet 135, 136, në paragrafin e dytë të nenit 137/a, në paragrafin e dytë të nenit 138, në nenet 138/a, 139, 140, 141, 141/a, në nenet 143/a, 143/b, 144/a, 151, 152, 153, 154, 154/a, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 155, në paragrafin e dytë të nenit 159, në paragrafin e dytë të nenit 160, në nenet 164/a, 164/b, 175, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 180 dhe në nenin 181/a të Kodit Penal, si dhe në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 59 të Kodit Penal Ushtarak;
 - f) vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 186/a, në paragrafin e dytë të nenit 187, në paragrafin e dytë të nenit 188, në nenet 190, 191, 192 dhe në paragrafin e dytë të nenit 192/b të Kodit Penal;
 - g) veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve, të parashikuara në paragrafët e tretë dhe të katërt të nenit 199/a dhe në nenin 199/b të Kodit Penal;
 - gj) vepra penale kundër mjedisit, të parashikuara në paragrafin e dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë të nenit 201, në nenet 201/a, 201/b, 201/c, 201/ç, 202, 202/b, 203, 206/a dhe 206/b të Kodit Penal;
 - h) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 dhe 225 të Kodit Penal;
 - i) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 dhe 228 të Kodit Penal;
 - j) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a dhe 234/b të Kodit Penal;
 - k) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 237, 243, 244, 244/a, 245, në paragrafin e dytë të nenit 247, në nenet 248, 248/a, 250, 252, 253, 257, 257/a, 258, 259,

- 259/a, 260, paragrafin e parë të nenit 263, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 267, 268, 270, 271, në paragrafët e parë, të dytë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë të nenit 278, në nenet 278/a, 278/b, në paragrafin e dytë të nenit 281, në paragrafin e dytë të nenit 282, në nenet 282/a, 282/b, 282/c, 283, 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 284/d, 285, 286, 287, 287/a, 287/b, 288, 288/a, 288/b, 288/c, 288/ç, në paragrafin e dytë të nenit 289, në paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt të nenit 290, në paragrafin e dytë të nenit 292, në nenet 293/a, 293/b, 293/c, 293/ç, 294, 295, në paragrafët e parë, të tretë, të katërt, të pestë dhe të gjashtë të nenit 295/a, në paragrafin e katërt dhe të pestë të nenit 298, në nenin 299 të Kodit Penal, si dhe në nenin 70 të Kodit Penal Ushtarak;”.
- l) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në nenet 302, 303, 305, 311, 312, 312/a, 313, 313/a, 313/b, 314, 316, 317, 318, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, në paragrafin e dytë të nenit 323, në nenin 324 dhe në paragrafin e dytë të nenit 324/a të Kodit Penal;
 - ll) vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 325, 326, 326/a, 327, 327/a, 328, 328/a, 328/b, 329, 330, 330/a, 331, 331/a, 332 dhe 332/a të Kodit Penal;
 - m) vepra penale të kryera nga banda të armatosura dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.
2. Pavarësisht nga parashikimet e shkronjave “b”, “ç”, “dh” dhe “e” të nenit 3 të këtij ligji, nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit personat e dënuar për:
- a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a dhe 75 të Kodit Penal;
 - b) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81 dhe 83/b të Kodit Penal;
 - c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, 88 dhe 89/a dhe 93 të Kodit Penal;
 - ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 103, 104, 105, 106, 107/a, 108 dhe në paragrafin e dytë të nenit 108/a të Kodit Penal;
 - d) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenet 109, 109/b, 109/c, në paragrafin e dytë të nenit 110, në nenet 110/a, 110/b, 110/c dhe 111 të Kodit Penal;
 - dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 114, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 117 dhe në nenin 121 të Kodit Penal;
 - e) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 124, në nenin 124/a, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 124/b, në nenet 128/a e 128/b dhe 129 të Kodit Penal;
 - ë) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në nenet 135, 136, në paragrafin e dytë të nenit 137/a, në paragrafin e dytë të nenit 138, në nenet 139, 140, 141, 143/a, 143/b, 144/a, 151, 152, 153, 154, 154/a, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 155, në paragrafin e dytë të nenit 159, në nenet 164/a, 164/b, 175, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 180 dhe nenin 181/a të Kodit Penal;
 - f) vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 186/a, në paragrafin e dytë të nenit 187, në paragrafin e dytë të nenit 188, në nenet 190, 191 dhe 192 dhe në paragrafin e dytë të nenit 192/b të Kodit Penal;
 - g) vepra penale kundër mjedisit, të parashikuara në paragrafin e dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë të nenit 201, 201/a, 201/b, 201/c, 201/ç, 202, 202/b, 203, 206/a, 206/b, të Kodit Penal;
 - gj) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 dhe 225 të Kodit Penal;

- h) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 dhe 228 të Kodit Penal;
- i) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a dhe 234/b të Kodit Penal;
- j) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 243, 244, 244/a, 245, 248, 248/a, 250, 253, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, paragrafin e parë të nenit 263, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 267, 268, në paragrafin e pestë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë të nenit 278, në nenet 278/a e 278/b, në paragrafin e dytë të nenit 281, në paragrafin e dytë të nenit 282, në nenet 282/a, 282/b, 282/c, 283, 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 284/d, 285, 286, 287, 287/a, 287/b, 288, 288/a, 288/b, 288/c, 288/ç, në paragrafin e dytë të nenit 289, në paragrafin e dytë, të tretë dhe të katërt të nenit 290, në paragrafin e dytë të nenit 292, në nenet 293/a, 293/b, 293/c, 293/ç, 294, 295, në paragrafin e parë, të tretë, të katërt, të pestë dhe të gjashtë të nenit 295/a, në paragrafin e katërt dhe të pestë të nenit 298 dhe në nenin 299 të Kodit Penal, si dhe në nenin 70 të Kodit Penal Ushtarak ;
- k) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në nenet 302, 303, 311, 312, 312/a, 313, 313/a, 313/b, 314, 316, 317, 318, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, në paragrafin e dytë të nenit 323, në nenin 324 dhe në paragrafin e dytë të nenit 324/a të Kodit Penal;
- l) vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 325, 326, 326/a, 327, 327/a, 328, 328/a, 328/b, 329, 330, 330/a, 331, 331/a, 332 dhe 332/a të Kodit Penal;
- ll) vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

Neni 5

Kriteret për përfitimin e amnistisë nga zbritja e dënimit

1. Të gjithë personave të dënuar, të cilët nuk plotësojnë kriteret për t'u përjashtuar nga vuajtja e dënimit, sipas nenit 3 të këtij ligji ose, edhe pse plotësojnë kriteret për përfitimin e amnistisë sipas këtij neni, nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit për shkak të kriterëve ndaluesë të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të këtij ligji, u zbritet:
 - a) 1 vit e gjysmë nga dënimi i mbetur, për personat e dënuar, gra, dhe të mitur;
 - b) 1 vit nga dënimi i mbetur, për personat e dënuar, burra.
2. Pavarësisht nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, nuk përfitojnë zbritje të dënimit:
 - a) personat e dënuar me burgim për veprat penale të parashikuara në nenet 79, 79/a, 79/b dhe 79/c të Kodit Penal;
 - b) personat e dënuar me burgim të përjetshëm.
3. Nuk përfitojnë nga zbritja e dënimit personat, të cilët i janë shmangur drejtësisë, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji.

Neni 6

Kriteret për përfitimin e amnistisë nga ndjekja penale

1. Përfshihen nga ndjekja penale të gjitha çështjet penale në hetim, çështjet e pashqyrtuara ose në proces shqyrtimi nga gjykatat, si dhe kallëzimet që ndodhen në këto organe, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, për veprat penale të kryera deri në datën **31.01.2024**, për të cilat Kodi Penal dhe Kodi Penal Ushtarak parashikon një dënim me burgim në maksimum deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, me përjashtim të veprave të parashikuara nga nenet 91, 96, në paragrafin e dytë të nenit 112, në nenet 119, 119/a, 119/b, 120, 121, 122, në paragrafin e parë të nenit 124/b, në nenet 125, 127, 204, 205, 206, 207, në paragrafin e parë të nenit **257/a**, në nenet 269 dhe 318 të Kodit Penal.”.
2. Nuk përfitojnë nga ky nen personat të cilët i janë shmangur drejtësisë.
3. Nuk përfitojnë nga pika 1 e këtij neni subjektet e posaçme, akuzat penale ndaj të cilave gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar sipas përcaktimeve të shkronjave “c” dhe “ç” të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 7

Të drejtat civile në procesin penal

Nga zbatimi i këtij ligji nuk cenohen të drejtat civile në procesin penal dhe as shpenzimet gjyqësore të kryera gjatë gjyqimit deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2024

PËR
DHËNIE AMNISTIE

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 e 2, shkronja “ë”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1
Qëllimi dhe parimet e ligjit

3. Qëllimi i këtij ligji është të përjashtojë nga vuajtja e dënimit dhe ndjekja penale, tërësisht ose pjesërisht, të gjithë personat që plotësojnë kriteret, sipas dispozitave të këtij ligji.
4. Dhënia e amnistië, sipas këtij ligji, udhëhiqet nga:
 - a) parimi i humanizmit;
 - b) arritja e qëllimit të dënimit;
 - c) rrezikshmëria e ulët e personave që amnistohen;
 - ç) edukimi dhe rehabilitimi;
 - d) mbrojtja e interesit publik;
 - dh) dhënia e mundësisë së integritimit më të lehtë dhe më të shpejtë të të dënuarve të mitur dhe femra;
 - e) rritja e efikasitetit në sistemin e drejtësisë;
 - ë) mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës.

3. Kudo në tekstin e projektligjit , afati 30.11.2023 zëvendësohet me afatin 31.01.2024.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

2. “I dënuar” konsiderohet:

- d) personi i dënuar nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe që, brenda afatit ligjor, nuk është bërë ankim në gjykatat përkatëse të apelit, duke marrë formë të prerë brenda datës **31.01.2024**;
 - e) personi i dënuar deri në datën **31.01.2024** nga gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykata e apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;
 - f) personi i dënuar deri në datën **31.01.2024** kur Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, si dhe personi i dënuar nga Gjykata e Lartë, kur kjo gjykatë ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë, deri në datën **31.01.2024**.
2. “Person që i është shmangur drejtësisë” është personi i fshehur, i arratisur ose i ikur, i cili, megjithëse ka dijeni, i shmanget me vullnet procedimit penal, zbatimit të masave të sigurimit ose ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të dënimit.

Neni 3

Kriteret për përfitimin e amnitisë nga vuajtja e dënimit

3. Përfshihen nga vuajtja e dënimit:

- f) personat meshkuj, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në **4 vjet** ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën **31.01.2024**, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi;
- g) personat femra, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në **5 vjet** ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën **31.01.2024**, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi;
- h) personat meshkuj, dënuar me burgim, të cilëve, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në **4 vjet**;
- ç) personat femra, dënuar me burgim, të cilave, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në **5 vjet**;
- i) personat e dënuar meshkuj, të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë baras ose mbi moshën 60 vjeç;
- dh) personat e dënuar femra, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 50 vjeç;
- j) personat e dënuar me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baras ose nën moshën 18 vjeç.

4. Nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit personat, të cilët i janë shmangur drejtësisë, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji.

Neni 4

Kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë

3. Pavarësisht nga parashikimet e shkronjave “a”, “c” dhe “d”, të nenit 3, të këtij ligji, nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit personat e dënuar për:

- n) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a dhe 75 të Kodit Penal;
- o) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 80, 81, 82, 83, 83/a, 83/b dhe 84/a të Kodit Penal, si dhe në nenin 77 të Kodit Penal Ushtarak;
- p) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, 88, 89/a, 93, 96 dhe 99 të Kodit Penal;
- ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 107/a, 108 dhe 108/a të Kodit Penal;
- q) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenet 109, 109/a, 109/b, 109/c, në paragrafin e dytë të nenit 110, në nenet 110/a, 110/b, 110/c dhe 111 të Kodit Penal;
- dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në nenin 114, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 117, në nenet 119, 120, 121 dhe 121/a të Kodit Penal;
- r) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 124, në nenin 124/a, në paragrafët e dytë e të tretë të nenit 124/b, në nenet 128/a, 128/b, 129 dhe 130/a të Kodit Penal;
- ë) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në paragrafin e tretë të nenit 134, në nenet 135, 136, në paragrafin e dytë të nenit 137/a, në paragrafin e dytë të nenit 138, në nenet 138/a, 139, 140, 141, 141/a, në nenet 143/a, 143/b, 144/a, 151, 152, 153, 154, 154/a, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 155, në paragrafin e dytë të nenit 159, në paragrafin e dytë të nenit 160, në nenet 164/a, 164/b, 175, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 180 dhe në nenin 181/a të Kodit Penal, si dhe në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 59 të Kodit Penal Ushtarak;
- s) vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 186/a, në paragrafin e dytë të nenit 187, në paragrafin e dytë të nenit 188, në nenet 190, 191, 192 dhe në paragrafin e dytë të nenit 192/b të Kodit Penal;
- t) veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve, të parashikuara në paragrafët e tretë dhe të katërt të nenit 199/a dhe në nenin 199/b të Kodit Penal;
- gj) vepra penale kundër mjedisit, të parashikuara në paragrafin e dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë të nenit 201, në nenet 201/a, 201/b, 201/c, 201/ç, 202, 202/b, 203, 206/a dhe 206/b të Kodit Penal;
- u) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 dhe 225 të Kodit Penal;
- v) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 dhe 228 të Kodit Penal;
- w) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a dhe 234/b të Kodit Penal;

- x) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 237, 243, 244, 244/a, 245, në paragrafin e dytë të nenit 247, në nenet 248, 248/a, 250, 252, 253, **257**, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, **paragrafin e parë të nenit 263**, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 267, 268, 270, 271, në paragrafët e parë, të dytë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë të nenit 278, në nenet 278/a, 278/b, në paragrafin e dytë të nenit 281, në paragrafin e dytë të nenit 282, në nenet 282/a, 282/b, 282/c, 283, 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 284/d, 285, 286, 287, 287/a, 287/b, 288, 288/a, 288/b, 288/c, 288/ç, në paragrafin e dytë të nenit 289, në paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt të nenit 290, në paragrafin e dytë të nenit 292, në nenet 293/a, 293/b, 293/c, 293/ç, 294, 295, në paragrafët e parë, të tretë, të katërt, të pestë dhe të gjashtë të nenit 295/a, në paragrafin e katërt dhe të pestë të nenit 298, në nenin 299 të Kodit Penal, si dhe në nenin 70 të Kodit Penal Ushtarak;”.
 - y) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në nenet 302, 303, 305, 311, 312, 312/a, 313, 313/a, 313/b, 314, 316, 317, 318, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, në paragrafin e dytë të nenit 323, në nenin 324 dhe në paragrafin e dytë të nenit 324/a të Kodit Penal;
 - ll) vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 325, 326, 326/a, 327, 327/a, 328, 328/a, 328/b, 329, 330, 330/a, 331, 331/a, 332 dhe 332/a të Kodit Penal;
 - z) vepra penale të kryera nga banda të armatosura dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.
4. Pavarësisht nga parashikimet e shkronjave “b”, “ç”, “dh” dhe “e” të nenit 3, të këtij ligji, nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit personat e dënuar për:
- m) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a dhe 75 të Kodit Penal;
 - n) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81 dhe 83/b të Kodit Penal;
 - o) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, 88 dhe 89/a dhe 93 të Kodit Penal;
 - ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 103, 104, 105, 106, 107/a, 108 dhe në paragrafin e dytë të nenit 108/a të Kodit Penal;
 - p) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenet 109, 109/b, 109/c, në paragrafin e dytë të nenit 110, në nenet 110/a, 110/b, 110/c dhe 111 të Kodit Penal;
 - dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 114, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 117 dhe në nenin 121 të Kodit Penal;
 - q) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 124, në nenin 124/a, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 124/b, në nenet 128/a e 128/b dhe 129 të Kodit Penal;
 - ë) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në nenet 135, 136, në paragrafin e dytë të nenit 137/a, në paragrafin e dytë të nenit 138, në nenet 139, 140, 141, 143/a, 143/b, 144/a, 151, 152, 153, 154, 154/a, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 155, në paragrafin e dytë të nenit 159, në nenet 164/a, 164/b, 175, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 180 dhe nenin 181/a të Kodit Penal;
 - r) vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 186/a, në paragrafin e dytë të nenit 187, në paragrafin e dytë të nenit 188, në nenet 190, 191 dhe 192 dhe në paragrafin e dytë të nenit 192/b të Kodit Penal;

- s) vepra penale kundër mjedisit, të parashikuara në paragrafin e dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë të nenit 201, 201/a, 201/b, 201/c, 201/ç, 202, 202/b, 203, 206/a, 206/b, të Kodit Penal;
- gj) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 dhe 225 të Kodit Penal;
- t) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 dhe 228 të Kodit Penal;
- u) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a dhe 234/b të Kodit Penal;
- v) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 243, 244, 244/a, 245, 248, 248/a, 250, 253, **257**, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, **paragrafin e parë të nenit 263**, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 267, 268, në paragrafin e pestë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë të nenit 278, në nenet 278/a e 278/b, në paragrafin e dytë të nenit 281, në paragrafin e dytë të nenit 282, në nenet 282/a, 282/b, 282/c, 283, 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 284/d, 285, 286, 287, 287/a, 287/b, 288, 288/a, 288/b, 288/c, 288/ç, në paragrafin e dytë të nenit 289, në paragrafin e dytë, të tretë dhe të katërt të nenit 290, në paragrafin e dytë të nenit 292, në nenet 293/a, 293/b, 293/c, 293/ç, 294, 295, në paragrafin e parë, të tretë, të katërt, të pestë dhe të gjashtë të nenit 295/a, në paragrafin e katërt dhe të pestë të nenit 298 dhe në nenin 299 të Kodit Penal, si dhe në nenin 70 të Kodit Penal Ushtarak ;
- w) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në nenet 302, 303, 311, 312, 312/a, 313, 313/a, 313/b, 314, 316, 317, 318, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, në paragrafin e dytë të nenit 323, në nenin 324 dhe në paragrafin e dytë të nenit 324/a të Kodit Penal;
- x) vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 325, 326, 326/a, 327, 327/a, 328, 328/a, 328/b, 329, 330, 330/a, 331, 331/a, 332 dhe 332/a të Kodit Penal;
- mm) vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

Neni 5

Kriteret për përfitimin e amnistisë nga zbritja e dënimit

3. Të gjithë personave të dënuar, të cilët nuk plotësojnë kriteret për t'u përjashtuar nga vuajtja e dënimit, sipas nenit 3 të këtij ligji ose, edhe pse plotësojnë kriteret për përfitimin e amnistisë sipas këtij neni, nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit për shkak të kriterëve ndaluese të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 4 të këtij ligji, u zbritet:
 - c) 1 vit e gjysmë nga dënimi i mbetur, për personat e dënuar, gra, dhe të mitur;
 - d) 1 vit nga dënimi i mbetur, për personat e dënuar, burra.
4. Pavarësisht nga parashikimet e pikës 1, të këtij neni, nuk përfitojnë zbritje të dënimit:
 - c) personat e dënuar me burgim për veprat penale të parashikuara në nenet 79, 79/a, 79/b dhe 79/c të Kodit Penal;
 - d) personat e dënuar me burgim të përjetshëm;
3. Nuk përfitojnë nga zbritja e dënimit personat, të cilët i janë shmangur drejtësisë, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji.

Neni 6
Kriteret për përfitimin e amnistisë nga ndjekja penale

1. Përfashtohen nga ndjekja penale të gjitha çështjet penale në hetim, çështjet e pashqyrtuara ose në proces shqyrtimi nga gjykatat, si dhe kallëzimet që ndodhen në këto organe, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, për veprat penale të kryera deri në datën **31.01.2024**, për të cilat Kodi Penal dhe Kodi Penal Ushtarak parashikon një dënim me burgim në maksimum deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, me përjashtim të veprave të parashikuara nga nenet 91, 96, në paragrafin e dytë të nenit 112, në nenet 119, 119/a, 119/b, 120, 121, 122, në paragrafin e parë të nenit 124/b, në nenet 125, 127, 204, 205, 206, 207, në paragrafin e parë të nenit **257/a**, në nenet 269 dhe 318 të Kodit Penal.”.
2. Nuk përfitojnë nga ky nen personat të cilët i janë shmangur drejtësisë.
3. Nuk përfitojnë nga pika 1 e këtij neni subjektet e posaçme, akuzat penale ndaj të cilave gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar sipas përcaktimeve të shkronjave “c” dhe “ç”, të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 7
Të drejtat civile në procesin penal

Nga zbatimi i këtij ligji nuk cenohen të drejtat civile në procesin penal dhe as shpenzimet gjyqësore të kryera gjatë gjykimit deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA